



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.01.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 19:40 dhe mbaroi në orën 19:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 5. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 6. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 7. Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i shkresës nr. 41 prot., datë 10.01.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, që njofton marrjen e vendimit nr. 05, datë 09.01.2019 nga ana e kësaj gjykate, për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj gjyqtarit Roland Hysi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Naureda Llagami: Mirëmbërëma!

Përsëritje!

Sot jemi mbledhur për të shqyrtuar çështjen e gjyqtarit Roland Hysi.

Doja t’ju informoja që nga Gjykata e Krimeve të Rënda është depozituar shkresa me nr. prot. 41, datë 10.01.2019 me lëndën “Njoftim mbi vendimin nr. 05, datë 09.01.2019 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Nga ana tjetër, po sot, më datë 10.01.2019 është depozituar edhe njoftimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, me shkresën nr. 228 prot., lidhur me njoftimin për procedimin dhe për masën ndaj gjyqtarit Roland Hysi.

Duke vlerësuar situatën, sot, në cilësinë e kryetares, njoftova mbledhjen për të shqyrtuar pezullimin e gjyqtarit Roland Hysi, në zbatim të ligjit, të neni 151 të ligjit “Për statusit...”.

Referuar nenin 151, parashikohet që magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit kur ndaj ti caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e veprave penale.

Me vendim të Gjykatës së Krimeve të Rënda nr. 5, i datës 09.01.2019, kjo gjykatë ka vendosur për gjyqtarin Roland Hysi *“Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues të arrestit në burg ndaj personit nën hetim Roland Hysi, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar në nenin 319, pika /ç/ i Kodit Penal.”*

Ndodhur në këto kushte, Këshilli do shqyrtojë pezullimin nga detyra të gjyqtarit Roland Hysi.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e vendimit, doja të shtoja a kemi ndonjë pyetje lidhur me... ose ndonjë koment lidhur me situatën?

Jo?!

Atëherë, të kalojmë në votimin e vendimit?

Gati?

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur sot më datë 10.01.2019, mbështetur në nenin 140 të Kushtetutës, në nenet 151, pika 2 dhe 155 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në shkresën e Gjykatës së Shkallës së parë Për Krimet e Rënda nr. 41 prot., datë 10.01.2019, bashkëlidhur të cilës është dhe vendimi nr. 05, datë 09.01.2019 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj gjyqtarit Roland Hysi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier”, vendosi të pezullojë nga ushtrimi i detyrës gjyqtarin Roland Hysi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak të masës së sigurisë “arrest me burg” dhënë me vendimin nr. 5, datë 09.01.2019 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Ky është propozimi. Jeni dakord me propozimin?

Mund ta shprehni?

Hapini mikrofonat!

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, ky vendim u miratua me shumicën e të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Me unanimitet.

Atëherë, ky ishte rendi i ditës. Mbledhja deklarohet e mbyllur. Faleminderit për pjesëmarrjen.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor